

L I G J
Nr.7786, datë 27.1.1994

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Çdo person, shqiptar a i huaj, i cili realizon të ardhura, është i detyruar të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, përveç rasteve që në këtë ligj caktohet ndryshe.

Personat fizikë rezidentë janë subjekt i tatimit për të ardhurat e përftuara nga burime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Personat fizikë të huaj janë subjekt i tatimit për të ardhurat e përftuara nga burime në Shqipëri.

Personat fizikë rezidentë janë personat që vendosen ose janë të pranishëm në Shqipëri, për një periudhë mbi 183 ditë gjatë një viti tatimor. Personat fizikë të huaj janë të gjithë personat fizikë që nuk janë persona rezidentë.

Personat fizikë , rezident të huaj, që trajtohen në bazë të marrëveshjeve qeveritare ndërkombëtare nuk janë subjekt i këtij ligji.

E ardhura konsiderohet se është nga burime në Shqipëri nëse është përftuar nga veprimtaria , kapitali , mallrat e shërbimet brenda territorit të Shqipërisë.

Neni 2

Kategoritë e të ardhurave të tatueshme janë këto:

1. Pagat.
2. Shpërblime për shërbime individuale.
3. Të ardhurat nga konkurset dhe llotaritë.
4. Të ardhurat nga qeratë e banesave, dyqaneve, magazinave, tokës dhe objekteve të tjera.

Neni 3

Nga tatimi mbi të ardhurat personale përjashtohen kategoritë e mëposhtme të të ardhurave:

1. Të ardhurat nga dhuratat e trashëgimitë.
2. Të ardhurat nga sigurimet.
3. Të ardhurat nga bursat e nxënësve dhe studentëve
4. Të ardhurat nga pensionet.
5. Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare.

Neni 4

Të ardhurat deri në 4.000 lekë në muaj përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Neni 5

Tatimi mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet për shërbime individuale vendoset si më poshtë:

1. Të ardhurat nga 4.000 deri në 10.000 lekë në muaj, shuma mbi 4.000 lekë në muaj tatohet 10 për qind.

2. Të ardhurat 10.001 deri në 20.000 lekë në muaj tatohen 600 lekë plus 15 për qind të shumës mbi 10.000 lekë.

3. Të ardhurat 20.001 deri në 30.000 lekë në muaj tatohen 2.100 lekë plus 20 për qind e shumës mbi 20.000 lekë.

4. Të ardhurat 30.001 deri në 40.000 lekë në muaj tatohen 4.100 lekë plus 25 për qind të shumës mbi 30.000 lekë.

5. Të ardhurat mbi 40.000 lekë në muaj tatohen 6600 lekë plus 30 për qind të shumës mbi 40.000.

Neni 6

Tatimi mbi të ardhurat personale për veprat krijuese është 5 për qind dhe për llojet e tjera të të ardhurave personale është 20 për qind.

Neni 7

Çdo individ a ndërmarrje që përfiton shërbime si nga marrëdhëniet i punësuar - punësues, ashtu edhe nga marrëveshje për shërbime individuale, mban tatimin për të ardhurat personale dhe e derdh atë në buxhetin e shtetit, në të njëjtën kohë me tërheqjen e pagesave, sipas mënyrës së përcaktuar nga Ministria e Financave.

Neni 8

Çdo individ a ndërmarrje që mban tatimin mbi të ardhurat personale nga pagesat sipas nenit 7, detyrohet të regjistrojë, të kryejë pagesat dhe t'i evidencojë ato sipas mënyrës së përcaktuar nga Ministria e Financave.

Neni 9

Banka detyrohet të vërtetojë, në momentin e tërheqjes së pagesave, ndalesat dhe derdhjet në buxhetin e shtetit, të tatimit mbi të ardhurat personale.

Neni 10

Çdo individ që realizon të ardhura, cilido qoftë burimi i tyre, për shuma mbi 4.000 lekë në muaj, detyrohet të deklarojë të ardhurat sipas mënyrës dhe formës së përcaktuar nga Ministria e Financave.

Neni 11

Të gjithë personat fizikë që i nënshtrohen tatimit mbi biznesin e vogël, nuk janë subjekt për tatimin mbi të ardhurat personale.

Neni 12

Personat fizikë rezidentë lejohen të kreditohen kundrejt detyrimit të tyre tatimor të përcaktuar sipas këtij ligji, për tatimin për të ardhurat personale të paguara në një shtet tjetër. Shuma e kredituar nuk kalon në asnjë rast shumën e detyrimit tatimor sipas këtij ligji, për të ardhurat personale me burim nga një shtet tjetër.

Neni 13

Ministria e Financave përcakton metoda të veçanta të llogaritjes së detyrimit tatimor për veprimtari dhe profesione të veçanta, duke u bazuar në faktorë të tillë, si të ardhurat totale vjetore, kapitali dhe numri i të punësuarve etj.

Neni 14

Quhen shkelje të ligjit:

1. Fshehja ose falsifikimi i të ardhurave personale.
2. Mosevidentimi i të ardhurave personale
3. Moskryerja e ndalesave dhe e derdhjeve të tatimit për të ardhurat personale.
4. Mosdhënia ose dhënia e deklaratës me vonesë.

Neni 15

Për shkeljet e parashikuara në nenin 14 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, merren këto masa:

1. Për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 14 të ligjit, personat fajtorë dënohen me gjobë në masën 5-fish të shumës së tatimit të fshehur dhe me marrjen 100 për qind të tatimit të fshehur.
2. Për rastet e parashikuara në pikat 2,3 dhe 4 të nenit 14 të këtij ligji personat fajtorë dënohen me gjobë në masën sa 2-fishi i detyrimit të tyre tatimor.

Neni 16

Ligji nr.7585, datë 14.7.1992, ndryshuar me ligjin nr.7628, datë 21.10.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet prej 15 janarit 1994.

Shpallur me dekretin nr.763, datë 9.2. 1994, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.